

PROCESVERBAL 24/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 1 (parë) për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 24.01.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;
3. Informatë për aktivitetet e KKS-së;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që e dini që kemi pas problem me komisionin e mëhershëm për arsye se dy anëtarë të komisionit kanë dhënë dorëheqje dhe ne jemi të obliguar që këtë çështje ta rregullojmë përsëri përmes Kuvendit dhe ta formojmë komisionin me anëtarë të ri të Kuvendit.

Kryesuesi - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Informatë për aktivitetet e KKS-së;

Avni Bytyqi - KKS është këshill funksional i cili njëherit ka mbajtur gjashtë takime. Në gjashtëmujorin e parë e kemi pas një informatë rreth aktiviteteve që i ka ndërmarr komuna jonë dhe gjithashtu edhe për gjashtëmujorin e dytë jemi të obliguar të japim informatë rreth aktiviteteve. Të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet që kanë dal nga KKS janë zbatuar dhe janë duke u implementuar në vazhdimsi. Zyrtari ligjor i njofton të pranishmit se mbrojtja e pyjeve ka kalu në agjensionin e pyjeve dhe Komuna nuk ka më përgjegjësi ndaj pyjeve.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3.

Pika 4. Të ndryshme;

Kryesuesi - te çështja e qenve endacak,a është bë ndonjë zgjidhje sepse po kemi problem shumë nëpër fshatra.

Avni Bytyqi - Komuna e ka udhëheq një procedurë për këtë çështje mirëpo ka pas një ankesë rreth çështjes së procedurës së prokurimit dhe çështja është në OSHP por besoj shumë shpejtë do të zgjidhet. Vërtetë është shqetësuese por pas procedurave të prokurimit besoj që Komuna ka me implementu ashtu si e kërkon ligji.

Takimi përfundoi: 09:15